

## Njoftim për konsultim publik

**Titulli i Projekt-aktit :** *“Plani i Përmirësimit të Shërbimit të Arsimit Parashkollor”*

**Propozuesi :** *Flamur Golemi, kryetari i bashkisë.*

**Sqarime për projekt-aktin :** *Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Gjirokastrë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin*

**Kalendari i konsultimit :** *Konsultimi publik do të realizohet në përputhje me Kalendarin e Konsultimit Publik*

**Pjesëmarrës :**

- **Nga ana e Bashkisë :** Anëtarë të Komisionit të Kulturës, Arsimit, Sporteve dhe Dhënies së Titujve të Nderit, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit, Kryetari i Komisionit të Shëndetësisë, Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazisë Gjinore, Sekretarja e Këshillit Bashkiak, Administrata e Drejtorisë së Arsimit të Bashkisë, Nkryetarja e Bashkisë që Mbulon Arsimin Parashkollor.
- **Nga komuniteti :** *Përfaqësues të Bordeve të Prindërv të kopshteve*

**Format e konsultimit :** *Takime publike*

Qëllimi i këshillimit publik	<p><i>Këshillimi publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve në lidhje me këtë projekt-akt, i cili prek të gjithë familjet, femijët e të cilave frekuentojnë kopshtet në territorin e bashkisë Gjirokastrë si dhe gjithë fëmijët në moshë kopshti që potencialisht mund të jenë frekuentues të këtyre kopshteve, pasi kopshti i fëmijëve është themeli i rrugëtimit arsimor të një fëmije, duke ofruar përfitime gjatë gjithë jetës përtej viteve të hershme.</i></p> <p><i>Duke njohur rëndësinë e arsimit parashkollor/kopshtit dhe duke investuar në aksesin dhe cilësinë e tij, për të siguruar një të ardhme më të ndritshme për fëmijët dhe shoqërinë e tij. Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion për ndikimin dhe efektet që ky vendim mund të ketë në komunitetin e Bashkisë, nëse ky projekt-vendim i shërben përmirësimit të jetës së komunitetit, nëse ai i shërben interesit publik si dhe</i></p>
------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	<p><i>nëse ai duhet miratuar sic është paraqitur, apo duhet të miratohet i përmirësuar.</i></p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti</p>	<p><i>Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërморën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin lokal dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.</i></p> <p><i>Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Gjirokastër mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një eksperience pune tetë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Gjirokastër, ka punuar për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte.</i></p> <p><i>Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Gjirokastë përqendrohet në <b>Proceset e Menaxhimit</b> të shërbimit në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv.</i></p> <p><i>Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë <b>Proceset Kryesore</b> dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Gjirokastër.</i></p> <p><i>Planifikimi dhe zbatimi i <b>Proceseve Mbështetëse</b> në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Gjirokastër është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët.</i></p> <p><i>Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë</i></p>

	<i>fëmijët.</i>
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	<p><i>1.Si e gjykoni situatën apo gjendjen e kopshteve në teritorin e Bashkisë Gjirokastër, si është situarta ne kopështin ku ju çoni fëmijën tuaj?</i></p> <p><i>2. A mendoni se plani dhe objektivat e tij i permbushin pritshmeritë tuaja ne lidhje me përmirësimin e cilësisë së kushtve në kopshte?</i></p> <p><i>3. Ç'farë do të sugjerimesh do tëkishit ju, sugjerime të cilat nuk janë përfshirë në dokumentat e këtij projekt-akti, në mënyrë që situata ne kopshte të ndryshojë virt pas viti në të mirë të fëmijëve tanë dhe komunitetit?</i></p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<p><i>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet pjesmarrjes Suaj në takimet publike, por në pamundësi për të marrë pjesë në këto konsultime, ato mund të dërgohen me email,ose të dërgohen me postë</i></p> <p><i>BRENDA DATËS 09.04.2024</i></p> <p><i>Email: <a href="mailto:zyoetleva69@gmail.com">zyoetleva69@gmail.com</a></i></p> <p><i>Adresa: Këshilli i Bashkisë, Sheshi “Çerçis Topulli”, Bashkia Gjirokastër Kati II.</i></p>
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	<p><a href="http://bashkiagjirokaster.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Draft-SIP-i-Rishikuar-Bashkia-Gjirokaster-me-komente.pdf">http://bashkiagjirokaster.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Draft-SIP-i-Rishikuar-Bashkia-Gjirokaster-me-komente.pdf</a></p>
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmerë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p><i>Konsultimi publik do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimeve Publike.</i></p> <p><i>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. Mbajtja e procesverbalit të cdo takimi publik dhe bërja publike e tyre.</i></li> <li><i>2. Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike.</i></li> <li><i>3. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të</i></li> </ol>

	<p><i>Rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje.</i></p> <p><i>4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Kulturës, Arsimit, Sporteve dhe Dhënies së Titujve të Nderit Komisionit të Ekonomisë dhe Financës dhe atij të Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazisë Gjinore</i></p> <p><i>5. Shqyrtimi nga ana e komisioneve (mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe diskutimi i tij në komisione për të dalë me një vendim se cilat propozime mund të merren në konsideratë dhe cilat nuk mund të merren dhe për çfarë arsye.</i></p> <p><i>6. Hartimi i projekt-vendimit të përmirësuar bazuar në rekomandimet e konsultimit publik.</i></p> <p><i>7. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit.</i></p> <p><i>8. Informimi i personave që kanë dhënë rekomandime për aktin, për marrjen në konsideratë të rekomandimit ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tij.</i></p> <p><i>9. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit</i></p> <p><i>10. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar</i></p> <p><i>11. Monitorimi i zbatimit të tij</i></p>
Data e publikimit	19 Mars 2024